



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 80/12
Prishtinë, më 10.10.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi Duda Balje dhe Muhamet Mustafa.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Dardan Gashi Ministër i MMPH dhe Arben Çitaku nga MMPH, Ramadan Avdiu zv. ministër i Financave, Xhabir Morina zv. Ministër i BPZHR, Agron Bajraktari nga MBPZHR, Ahmet Zejnullahu Drejtor i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës të MBPZHR, Sylejman Shaqiri Drejtor i RTK-së, Alexander Beetz, Ramadan Islami, Lukas Fischer, Rejhane Zylfijaj dhe Njomza Ilazi nga GIZ, Juergen Schatz (ekspert nga GIZ).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 26.09.2012;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Sharri", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
5. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-155 për Sistemin e Pagesave**
6. **Shqyrtimi i Projekcionit të buxhetit të RTK-së për periudhën Tetor –Dhjetor 2012**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sende të paluajtshme, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**

8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 26.09.2012

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet me disa vërejtje teknike që do të përmirësohen.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Sharri", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja theksoi se për shkak të disa paqartësive buxhetore dhe për shkak të vlerësimit për ndikimin buxhetor shtesë nga departamenti i buxhetit të MF, por edhe ajo nga është paraqit me amandamentet, komisioni në takimin e fundi ka vendosur të shtyj për shqyrtim këtë projektligj dhe ti ftojme ministrin e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural dhe ministrin e financave.

Dardan Gashi theksoi se këto dy projektligje janë të përcjellura më shumë debate publike, dhe ka pas paqartësi rreth implikimeve buxhetore dhe kërkojë që këto dy pika të shtyhen për ndonjë mbledhje tjetër. Kemi marr shumë peticione nga shumica e banorëve që përfshijnë bjeshkët e Nemuna dhe jemi në diskutim e sipër që të kthehet në qeveri për rishqyrtim. Megjithatë sa i përket projektligjit për parkun kombëtar Sharri, implikimet buxhetore janë minimale apo të përmallueshme për ministrin, pasi që ekziston departamenti dhe nuk përfshihet as një zgjerim i stafit e as i shpenzimeve. Sa i përket projektligji për parkun kombëtar Bjeshkët e Nemuna, mund të tërhiqet për një periudhë të caktuar deri sa të kryhen diskutimet publike.

Latif Gashi kërkon disa sqarime, sa përqind e pyjeve është park racional, a keni planifikuar ju për hapësirën që do të bëhet park racional apo keni planifikuar shpronësim dhe sa është kostoja buxhetore e pronave private. Mendojë që kjo çështje do trajtim më të shumë dhe projektligjet duhet kthyer në qeveri.

Sali Asllanaj ministri theksoi se do të tërheq projektligjet, dhe është mirë të precizohet a do të tërhiqet që të mos diskutojmë fare a nuk tërhiqet dhe procedojmë krejt normalisht.

Dardan Gashi sa i përket bjeshkëve të Nemuna, janë paraparë që 60.000 hektar të bëhen pjesë e parkut nacional, ndërsa për parkun e Sharrit deri në 20.000 hektar. Është pronë që i ka takuar një kompanie shoqërore, pra është publike e jo private dhe ligjet nuk parashohin shpronësimin dhe se ky projektligj nuk parasheh ndryshimi të pronës. Sa i përket pyetjes së zotit Asllanaj, kërkesa jonë është të mos shqyrtohet projektligji për bjeshkët të Nemuna dhe sipas gjitha gjasave do të tërhiqet, pasi që ka keqkuptime dhe kërkohet konsultime dhe sqarime shtesë me banorët.

Ahmet Zejnullahu sa i përket parkut nacional të Sharrit deri me tash kanë qenë të përfshirë 39.500 hektar, e në PL e ri janë 53.469 hektar. Kemi pasur takime të përbashkëta me ministrin e mjedisit mirëpo nuk kemi pas harmonizim të qëndrimeve na i kemi dhënë disa vërejtje që kanë qenë zvogëlimi i disa sipërfaqeve

pyjore. Kemi edhe prona private të përfshijnë rreth 37.500 hektar dhe janë rreth 1000 pronar privat. Janë 3 zona mirëpo nuk e dijmë sipërfaqet sa do të jenë implikimet buxhetore. Ka nevojë për harmonizimin e qëndrimeve në mes dy ministrive.

Latif Gashi Zv. Ministër vet fjala park nacional e kupton që merret në pronësi të shtetit edhe i bëhet kufizimi i pronës private. Të lutem disa shtete si Austria, Gjermania i kanë 3 % parqet nacionale. Këto projektligje kanë implikime buxhetore, të kthehen dhe të rishikohen edhe ti harmonizoni çështjet të dy ministrit edhe me ministrin e financave dhe pastaj të procedohen për shqyrtim në Kuvend.

Dardan Gashi ky projektligj nuk i sqaron çështjet shpronësore edhe ato mbeten ashtu siq janë. Park kombëtar i bjen mbrojtje të shtetit e jo ne pronë të shtetit është dallim esencial park nacional.

Latif Gashi cili është dallimi i pyjeve tjera edhe parkut nacional edhe cilat pyje janë në mbrojtje të shtetit. Në zonat private nuk guxon të priten pyjet pa leje andaj cili është dallimi mes parkut nacional edhe pyllit privat?

Dardan Gashi parku nacional është përkufizuar me ligjin e natyrës. Nuk janë 23 %, por janë 10% pronat private, dhe projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Kryetarja mendoj se nuk është e rregulluar në mënyrë të qartë se a do të ekziston një drejtori në nivelin qendror për të dy parqet apo do të krijohen drejtori të veçanta për menaxhimin e parkut të caktuar. Kjo çështje nuk është e sqaruar mirë në projektligj. Në nenin 4 thuhet se themelohet drejtoria për menaxhimin e parkut nacional Sharri, por nuk sqarohet qfarë ndodhë me departamentin regjional të Prizrenit. Kjo është pak problem se nëse formohet një drejtori e re, prodhon efekte buxhetore. Po ashtu me amendamentin e komisionit funksional është zvogëluar afati për 3 muaj për themelimin e drejtorie së re.

Dardan Gashi, drejtoria ekziston prej pas luftës dhe me këtë projektligj shëndrohet në drejtorin e re. Nuk prodhon implikime buxhetore shtesë dhe rritje të numri të punëtorëve. Është bërë vetëm zgjerimi i territorit dhe do të mbulohet me të njëjtët punëtor që është mbuluar deri më tash.

Naser Osmani neve na intereson çështja e implikimeve buxhetore. Nëse ligji nuk ka implikime buxhetore e 3 ministrit e pranishme janë dakord që të procedohet për në Kuvend atëherë unë nuk shoh se ne mund të bëjmë ndonjë ndryshim. Ne mund të bëjmë një kërkesë që nga ministria e financave të shprehet se a është vlerësimi buxhetor siq është këtu i paraqitur në draft.

Xhabir Morina ne si ministri kemi ngritur vërejtjet, mos pajtimet si dhe sugjerimet tona, lidhur me këto dy parqe nacionale. Duhet thënë se ministria jonë nuk ka marrë pjesë në hartimin e dy projektligjeve, e së dyti këto PL bien në kundërshtim me ligjin e pyjeve. Së fundi sipas informacioneve tona ka kosto dhe implikime buxhetore. Deri sa të harmonizohen mirë edhe për parkun kombëtar të Sharrit edhe për bjeshkët e Nemuna pajtohem që të tërhiqet PL.

Ramadan Avdiu sa i përket PL për parkun nacional Sharri, ministria e ka shqyrtuar dhe ka deklaruar se aprovimi i këtij ligji nuk ka implikime të drejtpërdrejta buxhetore. Nga ndarjet buxhetore që ka ministria sponsorizuese, konkretisht drejtoria e përgjithshme për mbrojtjen e pyjeve në Prizren, mund ti mbuloj të gjitha shpenzimet me implementimin e ligjit.

Latif Gashi zv ministër a keni kontaktuar me ministrin e juaj pasi që ministri juaj thotë se kanë implikime buxhetore këto dy PL dhe ato janë fshehur nga sponsorizuesi i ligjit .

Ramadan Avdiu analizat e shërbimeve profesionale të ministrisë së financave nuk tregojnë që ky ligj ka kosto shtesë.

Kryetarja kemi një vërejtje për ministrin e financave se kemi kërkuar të na dërgoj një person permanent për pjesëmarrje në takimet e Komisionit dhe është dashur që ai të jetë këtu që ti analizojmë kostot buxhetore.

Hasime Krasniqi projektligji duhet të kalojë në harmonizim të plotë mes ministrive dhe organeve tjera përgjegjëse në mënyrë që kur të aprovohet ligji të jetë i zbatueshëm. Edhe pse nga deklarata financiare thuhet se nuk ka kosto shtesë, gjatë diskutimeve vërehet që ky PL prodhon kosto shtesë. Andaj unë propozoj që me një dokument të sqarohet cila është kosto shtesë e këtij PL dhe ku janë paraparë të gjenden këto mjete.

Naser Osmani edhe pasi që MF thotë që nuk ka kosto shtesë agjencioni i pyjeve po e kundërshton këtë PL. Ndërsa unë mendoj që agjencioni i pyjeve duhet fuqimisht ta përkrah mbrojtjen e pyjeve. Atëherë a mund të na sqaroni qëllimin e vërtet që mos të përkrahet ligji për parkun kombëtar të Sharrit?

Sali Asllanaj nuk më duket e logjikshme të thuhet se nuk ka implikime buxhetore kur parkut nacional Sharri po i shtohen 20 mijë hektar të tjerë nën mbikëqyrje. Zgjerimi i sipërfaqes së parkut nacional Sharri nuk duhet të cungoj të drejtat e pronarëve privat si dhe pengimin e shfrytëzimit të mineraleve të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Muhamet Mustafa ne kemi një qëndrim pozitiv për sa i përket mbrojtjes së pasurive të veçanta të Kosovës. Mirëpo më mirë është të shtyhet ky ligj edhe dy muaj në mënyrë që të adresohen problemet. Ministri tha se ligji nuk e prek pronën private mirëpo ky ligj e kufizon pronarin të nxjerrë dobitë nga prona andaj duhet të shihet si të kompenzohen ata pronarë. Ky projektligj përmban efekte të padeklaruara buxhetore andaj unë sugjeroj të tërhiqet ky projektligj dhe të sqarohen këto çështje.

Dardan Gashi ministria e mjedisit është e interesuar që me këtë PL të mbrohen këto pyje brenda për brenda resurseve tona dhe nuk ka se qfarë fsheh në favor të askujt. Sa i përket lejeve për shfrytëzim e të mirave natyrore në Kosovë, duhet të kërkohet leje relevante për shfrytëzim qoftë të ujit apo të pyjeve. Parku nacional është i ndarë në 3 zona, ku zona e parë gjendet në mbi 2 mijë metra lartësi, zona e dytë është lejuar për aktivitete turizmi në zonat ku nuk ka aktivitete kimike si dhe zona e tretë ku janë zonat e banimin ku lejohet gjithçka përveç prerjes së pa kontrolluar të pyjeve.

Kryetarja sqaron se amendamentin 6 të komisionit funksional është shtuar një nen i ri dhe është thënë se të drejtat pronësore rregullohen me ligje të veçanta, dhe ligjet e tilla që rregullojnë këtë çështje nuk ekzistojnë dhe kjo në aspektin buxhetor krijon paqartësi buxhetore.

Hykmete Bajrami shprehi shqetësimin lidhur me amendamentin 6 dhe tha se deputet në parlament nuk e votojnë vetëm koston buxhetore mirëpo për projektligjin në tërësi. Duhet të gjendjet një mënyrë që pronarët e pronave private të cilat bëhen pjesë e parkut nacional të kompenzohen pasiqë me këtë PL të mirat e kësaj prone nuk mund të shfrytëzohen nga pronarët.

Alban Fetoshi theksoi se është me rëndësi miratimi i këtij Projektligjit, dhe se kostoja buxhetore duhet të vlerësohet në bazë të rëndësisë së ligjit. Kemi pasur raste kur kemi miratuar ligje me vlerësim të koston së lartë buxhetore. Pyjet në Kosovë duhet të jenë në mbrojtje të shtetit, në mënyrë që mos të vazhdohet me shkatërrimin e tyre siç është bërë deri më tani.

Kryetarja ne duhet ti vazhdojmë procedurat pasi që Projektligji ka ardhur në Kuvend, ndërsa ministria mund ta tërheq PL deri sa të miratohet në lexim të dytë.

Arben Çitaku projektligji bazën kryesore e ka në ligjin e natyrën ku edhe përcaktohen zonat në bazë të shtazëve të rralla të cilat egzistojnë në ato zona. Ndarja nëpër zona ka si qëllim mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e pa kontrolluara dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

Muhamet Mustafa unë jam pro miratimit të një ligjit të këtillë, mirëpo ministria duhet ta sjellë një studim të fizibilitetit kur propozon një park nacional. Duhet të shihet se sa janë përfitimet, sa janë kompenzimet dhe në këtë mënyrë do të adresohen çështjet me buxhet e jo të thuhet se ka efekte buxhetore të fshehura. Andaj ky PL duhet të kthehet në qeveri dhe të sjelljet përsëri me një studim fizibiliteti.

Kryetarja në bazë të analizave që janë bërë, vërehet që ka paqartësi buxhetore pasi që çështja e kompenzimit të pronës private nuk është rregulluar. Propozojë që të riformulohet neni 4 dhe të thuhet që Ministria e Mjedisit me vendim e shëndrron drejtorinë e regjionale të Prizrenit në drejtorin për administrimin e parkut kombëtar “Sharri” dhe të procedojmë projektligjin më tutje.

Latif Gashi unë propozojë që së pari të bëhet harmonizimi i ligjeve si dhe i qëndrimeve mes ministrive dhe agjencioneve e pastaj të sjelljet ligji të cilin ne e shqyrtojmë e pastaj e votojmë.

Kryetarja ne nuk kemi kompetenca ta kthejmë PL mirëpo mund të definojmë se ka kosto shtesë buxhetore. Çështjet e diskutuara sot janë çështje që duhet diskutuar në seancë plenare.

Albana Fetoshi unë mendoj që PL nuk duhet të kthehet sepse ministrinë mund të mos i harmonizojnë qëndrimet dhe këto ligjet nuk do të kryhen as këtë vit as vitin tjetër. Andaj komisioni duhet të diskutojmë ligjin se a duhet kaloj apo jo. Për sa i përket kostove buxhetore për kompenzimin e pronës private atë çështje e rregullon komisioni dhe deputetët.

Pas diskutimeve, Komisioni doli me dy propozime:

Propozimi i parë, për të cilin votuan (Një Për: Albana Fetoshi, tre Abstenime: Safete Hadergjona, Xhevdet Neziraj dhe Duda Balje, dhe gjashtë kundër: Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Hykmete Bajrami dhe Jelena Bontic), si në vijim:

Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë me përjashtim të nenit 4, i cili propozohet të riformulohet: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me vendim e shndërron drejtorinë e regjionale të Prizrenit në drejtorin për administrimin e parkut kombëtar “Sharri”.

Propozimi i dytë: Projektligji përmban implikime buxhetore shtesë dhe duhet ti kthehet Qeverisë për rishikim dhe harmonizuar të çështjeve që rregullohen me këtë projektligj.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, komisioni me shumicë votash nxorri këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr.04/L-87 për Parkun Kombëtar “Sharri”, përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për Projektligjin nr.04/L-87 për Parkun Kombëtar “Sharri”, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 6.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja në bazë të deklaratës financiare shifet se parashihet të shtohet numri i të punësuarve për 17 punëtorë me një kosto buxhetore mbi 100.000 euro. Thuhet se deri në vitin 2014 Ministria sponsorizuese mund ti absorboj brenda ndarjeve buxhetore, ndërsa që nga 2015 do të jenë ngarkesë e buxhetit të Kosovës.

Latif Gashi mendojë se nuk ka nevojë që të shqyrtohet kjo pikë e rendit të ditës pasi vet ministri u deklarua se do të tërhiqet pasi ka probleme me këtë projektligj.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për Projektligjin nr. 04/L-86 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 5 dhe 6.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave

Kryetarja projektligji shumë i rëndësishëm dhe rregullon një problematik të rëndësishme siq është sistemi i pagesave, i cili më përpara ka qenë i rregulluar me rregullore. Mendoj që na është ofruar një projektligj i mirë që sistemi i pagesave tani e tutje të rregullohet me ligj.

Ramadan Avdiu raportoi se që nga viti 2001 sistemi i pagesave edhe ne Republikën e Kosovës është rregulluar sipas rregullores së UNMIK-ut 2001/26. Me qëllim të rregullimit dhe azhurnimit të strukturës ligjore që ka të bëjë me sistemin e pagesave ne Republikën e Kosovës, MF në bashkëpunim me si dhe ne përkrahjen e institucioneve ndërkombëtare ka hartuar PL për sistemin e pagesave përmes të cilit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në sistemet e pagesave. Me këtë ligj do të vendoset një infrastrukturë ligjore bashkohore në bashkëpunim me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. PL nuk ka implikime buxhetore shtesë, përkundrazi do të kemi të hyra nga zbatimi i ligjit.

Hasime Krasniqi duke u bazuar në ata që tha zv.ministri dhe duke e ditur rëndësinë e këtij PL, i cili i ka munguar sistemit tonë të pagesave, mendoj se duhet ta mbështesim në parim deisa nuk ka kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për sistemin e pagesave.

4. Shqyrtimi i Projekcionit të buxhetit të RTK-së për periudhën Tetor –Dhjetor 2012

Kryetarja materiali i dorëzuar nga RTK-ja paraqet pasqyrat e shpenzimeve për periudhën Janar-Shator si dhe një plan për 3 mujorin e fundit Shtator-Dhjetor. Nga raporti të cilin na ka sjell RTK ja shifet se ne

shumë vija buxhetore ka tejkalime për gjashtë mujorin e parë. Nëse marrim dhe i shikojmë projeksionet e buxhetit vërejmë që ka ndryshime nga ajo që që janë miratuar në fillim të vitit. Tek kategoritë e ndryshme ekonomike siq janë Paga dhe Meditje, Mallra dhe Shërbime vërehet që nuk e njëjta shumë e cila është paraqitur në fillim të vitit dhe asaj që po na paraqitet tani nga kërkesa e RTK-së.

Sylejman Shaqiri janë sqarime të cilat duhet përsëritur sikur që ka qenë herën e kaluar. Shkaqet janë po të njëjtat, çështja e shkurtimit të buxhetit paraprak dhe këto janë problemet të cilat na kanë përcjellur gjatë gjithë vitit. RTK-ja e ka ruajt funksionimin e transmetuesit publik me këtë buxhet.

Muhamet Mustafa nga material shifet se për nëntë muaj, RTK pothuajse e ka kaluar buxhetin që e ka pasur të aprovuar. Do të duhej informata shtesë se si mendon menagjmentit e bordi i RTK-së ti mbulojë tejkalimin e shpenzimeve. Duhet ti paraqitni sa buxhet ju ka mbetur pa u shpenzuar, sa i keni të ardhurat, borxhet, në mënyrë që ne të shohim situatën. Unë mendoj që duhet bërë analizë e thellë dhe të adresohen problemet, të shihet ku mund të bëhet shfrytëzim më i mirë, ku mund të rriten të ardhurat e juaja dhe ku mund të zvogëlohen shpenzime dhe të gjejmë një zgjidhje.

Hasime Krasniqi është shqetësuese situata në bazë të shifrave të raportuara nga drejtori i RTK-së. Nuk mund të pranohet një raport i tillë përderisa nuk ka propozime apo informata shtesë se si do të mbulohen shpenzimet. Pothuajse në çdo zë buxhetor ka ndryshim mes shpenzimeve të parapara dhe atyre aktuale, gjë që tregon një planifikim jo të mirë dhe një rritje të obligimeve të RTK-së. Si është paraparë të mbulohen shpenzimet pasi që veçse jemi në tre mujorin e fundit të këtij viti?

Latif Gashi theksoi se për të dhënë llogari mbi gjendjen e rëndë financiare të RTK-së, të pranishëm do të duhej të ishin edhe drejtori financiar si dhe kryetari i bordit, e jo vetën drejtori i RTK-së. Ju thatë që borxhet po krijohen si rezultat i shkurtimeve buxhetore mirëpo kjo nuk qëndron pasi që parlamenti e cakton saktësisht shumën e buxhetit të RTK-së. Nga kërkesa e dërguar shifet se kemi tejkalim të buxhetit për paga dhe meditje nga ajo që është miratuar. Andaj duhet të keni shumë kujdes mbi shpenzimin e buxhetit tuaj.

Kryetarja nga kërkesa e prezantuar, shifet se kemi tejkalimin të shpenzimeve nga ajo që është planifikuar në fillim të vitit. Këto mjete janë të taksapaguesve andaj ne si komision kemi përgjegjësi të shikojmë përse nuk ka një planifikim serioz mbi buxhetin e RTK-së.

Sylejman Shaqiri pajtohem që kryetari i bordit si dhe shefi i financave duhej të ishin prezent dhe kërkoj që sa më shpejt të realizohet ky takim sepse tanimë jemi në fund të muajit tetor dhe na duhet mjete për realizimin e obligimeve në mënyrë që të mos rrezikohet programi i RTK-së.

Kryetarja ne i kuptojmë urgjencat mirëpo edhe RTK-ja duhet ta dijë që materialet kanë nevojë të analizohen nga anëtarët e komisionit. Propozojë që RTK-ja të sjellë materialet plotësuese dhe të bëjë një arsyetim mbi kërkesën buxhetore për tre muajt e fundit. Gjithashtu këto materiale duhet të përmbajnë të hyrat e RTK-së, mbetjet nga buxheti i pa realizuar, borxhi i trashëguar në mënyrë që të shohim sa përputhen projeksionet e 3 mujorit me planin vjetor.

Pas diskutimeve, Komisioni një zëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Shtyhet shqyrtimi i Projeksionit të buxhetit të RTK-së për periudhën Tetor –Dhjetor 2012. Kërkohet nga RTK-ja të sjellë materiale shtesë të detalizuara mbi të hyrat, buxhetin si dhe borxhet e RTK-së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sende të paluajtshme, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Pas diskutimeve, Komisioni një zëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amandamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Pas diskutimeve, Komisioni një zëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amandamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

9. Të ndryshme

9.1. Kryetarja njoftoi se grupi punues për menaxhimin e financave publike, është duke vazhduar në monitorimin në teren dhe deri më tani ka realizuar disa vizita në terren.

9.2. Kryetarja njoftoi se me qëllim të standardizimit të formave të parashtrimit të kërkesave buxhetore dhe raporteve financiare që parashtrohen në komision, GIZ ka përgatitur një draft i cili përcakton mënyrën e parashtrimit të kërkesave nga organizatat buxhetore dhe një draft për raportet financiare që dërgohen nga agjencionet e pavarura.

Jürgen Schatz njoftoi për angazhimin e tij në hartimin e drafteve. Përmendi që për krijimin e këtij drafti është konsultuar legjislacioni përkatës dhe janë analizuar raportet e agjencioneve të pavarura. Mendoj që këta formular krijojnë një bazë të mirë të raportimit gjë që do të lehtësoj punën e komisionit me rastin e analizimit të raportimeve financiare të organizatave buxhetore si dhe kërkesave shtesë buxhetore.

Komisioni njëzëri shprehu pëlqimin që formulari për paraqitjen e kërkesave buxhetore dhe formulari për raportime financiare, me disa ndryshime të vogla që do të bëhen, të shërbejnë si dokumente pune të komisionit me rastin e shqyrtimit të kërkesave financiare respektivisht raportimeve financiare të institucioneve dhe agjencioneve të pavarura.

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona